



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME/VRHOVNI SUD

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 7 nëntor 2022, me shumicë votash nxjerr këtë:

**PLOTËSIM I UDHËZIMIT**

Pas pikës e) të udhëzimit Agj.nr.183/2019 të datës 30 maj 2019 i shtohet edhe pika;

ë) Rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor, sipas nenit 255, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Publik, në të cilën është shkakuar vet-aksident trafiku dhe me këtë rast ka pësuar lëndime vetëm vozitësi i mjetit, pa dëm pasuror të dikujt tjetër, kryesi i kundërvajtjes përgjigjet vetëm për shkelje të ndonjë rregulli tjetër të trafikut publik, por jo edhe për lëndimet trupore që i ka shkakuar vetes.

**Arsyetim**

Gjykata Supreme e Kosovës në Mbledhjen e Përgjithshme më datë 30 maj 2019 me shumicë votash ka nxjerr udhëzimin Agj.nr.183/2019 me të cilin gjykatat në nivel vendi

i ka udhëzuar lidhur me risitë e dispozitës së nenit 370 të KPK-së, e që përcakton veprën penale Rrezikimi i trafikut publik.

Drejtorit i Divizionit të Komunikacionit Rrugor Nënkolonel Jeton Rexhepi, kryetarit të kësaj gjykate i është drejtuar me kërkesë që të udhëzojë, se si të veprojnë me rastet e vet-aksidenteve të trafikut, pasi që Gjykatat Themelore – Divizionet për Kundërvajtje në Prishtinë – dega në Lipjan dhe në Prizren, dega në Suharekë, kanë vendosur ndryshe në dy raste të ngjashme. Me këtë rast ka bashkangjitur një aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Divizionit për Kundërvajtje – dega në Lipjan si dhe një akt të Gjykatës Themelore në Prizren- Divizioni për kundërvajtje dega Suharekë, me të cilin kjo gjykatë është shpallur jo kompetente. Pas analizimit të çështjeve juridike kontestuese lidhur me këtë rast, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e përgjithshme të kësaj gjykate, konstatoi si vijon:

Ligjdhënësi edhe te vepra penale nga neni 370 të KPK-së, por edhe te dispozita e nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Publik në kapitullin - Masat e posaçme të Kundërvajtjes, ekskluzivisht si kryes të veprës penale apo kundërvajtjes e konsideron personin i cili me veprimet e tij i shkakton dikujt tjetër lëndime trupore apo dëm pasuror. Me këtë rast nuk mund që veprimet inkriminuese t'i përshkruhen apo mveshen kryesit të veprës penale ose kundërvajtësit nga gjykata apo organi administrativ kompetent për rregullat e trafikut rrugor, nëse me atë rast kryesi në vet-aksident pëson lëndime, pasi që në të dy rastet nuk mundet me qenë edhe i dëmtuar edhe kryes i veprës penale apo kundërvajtjes. Në këtë situatë, nëse kryesi i kundërvajtjes me veprimet e tij sajton ndonjë kundërvajtje tjetër sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor e që varet prej rastit në rast, organi kompetent ka të drejtë të inicioi procedurën kundërvajtjes për shkelje tjera e jo për lëndimet që me fajin e tij vet i ka pësuar, pasi që në këtë situatë ai do ta marr edhe rolin e palës së dëmtuar.

*(Plotësim Udhëzimi, i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 07 nëntor 2022)*